



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

Nr. 3201/1 Prot.

Tiranë, më 11.11.2025

V E N D I M

Nr. 62 datë. 11.11.2025

**“PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË Z. ERVIN ALIU NË VENDIN VAKANT PËR
INSPEKTOR JOMAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I
DREJTËSISË MË DATË 27.05.2024”**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Znj. Elena Pelushi - Kryetar

Znj. Lindita Ziguri – Anëtar

Znj. Joana Sorraj - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Eljona Bylykbashi

Znj. Zonje Shelqizi

Znj. Amanta Jasa

Në mbledhjen e datës **10.11.2025**, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit për inspektor jomagjistrat:

Z. Ervin Aliu

OBJEKTI: Urdhërimi i lejit të kandidimit të Z. Ervin Aliu, në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.

Komiteti pasi u njoh me aktet si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 27.05.2024, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 4 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 74 datë 26.06.2024 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 26.06.2024, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 02.07.2024, ku vendosi për shqyrtimin e dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistrat për pozicionin e inspektorit".
4. Z. Ervin Aliu, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. 1810 prot., datë 26.06.2024 për vendin vakant të Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për t'u paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të

ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë". Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 09.07.2024, kandidati Ervin Aliu, është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit i Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
6. Në datën 23.07.2024, kandidati Ervin Aliu ka depozituar pranë sekretariatit teknik formularët e deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me shkresën nr. 2230 prot., datë 03.08.2024, i ka dërguar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve, që i nënshtrohen procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre.
8. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Ervin Aliu, ku deklarohet se është pajisur me kredencialet dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të

- llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
9. Kandidati Ervin Aliu e ka përmbushur detyrimin për të plotësuar në sistemin EACID dhe dorëzuar elektronikisht dhe fizikisht të plotësuar pranë ILDKPKI-së Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.
 10. ILDKPKI, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *"Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit"*, me aktin nr. 207/23 prot, datë 19.12.2024, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e përfundimit të kontrollit të ushtruar për kandidatin z. Ervin Aliu dhe personat e lidhur me të.
 11. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, si dhe në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *"Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit"*, ky institucion kryen verifikime pranë subjekteve publike dhe private që lejon ligji, të të dhënave mbi pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Ervin Aliu dhe personave të lidhur me të, si dhe administron/analizon të dhënat që dalin nga procesi i verifikimi të kriterit të pasurisë.
 12. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit z. Ervin Aliu referuar aktit të përfundimit të kontrollit të deklaratës së pasurisë rezulton se, ILDKPKI me shkresën nr. 207 prot., datë 08.08.2024 i është drejtuar me kërkesa për informacion lidhur me kandidatin z. Ervin Aliu institucioneve: *"Banka e Shqipërisë", Banka "Raiffeisen" SHA, "Banka Kombëtare Tregtare" SHA, Banka "Intesa Sanpaolo" SHA, Banka Tirana SHA, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka "ProCredit" SHA, Banka e Parë e Investimeve SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA, Banka "Credins" SHA, Banka Union SHA, Banka "OTP Albania" SHA, "Raiffeisen Leasing" SHA, Porsche Leasing SHA, RFZ Invest SHA, "Credins Invest" SHA, DPSHTRR, "Qendra Kombëtare e Biznesit", DPT, ISSH, D.P Detare, ASHK online.*
 13. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në mbështetje të nenit 209, pika 6, germa "a" dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"*, të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit C, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *"Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e*

inspektorit", kandidati, z. Ervin Aliu ka depozituar diplomën nr. 6452, datë 06.07.2000 të arsimit të lartë lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku vërtetohet se ka marrë titullin "Jurist". Kjo diplomë, referuar nenit 124/2 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", ku parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), sipas parimeve të procesit të Bolonjës, është ekuivalente me diplomat "Master i shkencave".

14. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Ervin Aliu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion edhe disa organeve ligjzbatuese, të cilët kanë kthyer përgjigjet përkatëse.
15. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me shkresën me nr. 2234 prot., datë 03.08.2024, sërish lidhur me integritetin është kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke verifikuar mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të Kreut III dhe në zbatim të pikës 2, germa "b" Kreu V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Gjithashtu, në zbatim të kriterit të përcaktuar në pikën 6, germa "d" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, për verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit z. Ervin Aliu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresën nr. 2235 prot., datë 03.08.2024, Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me verifikimin nëse ndaj kandidatit janë zhvilluar procese gjyqësore të karakterit penal, dhe nëse rezultojnë të dënuar, për efekt të gjendjes gjyqësore. Informacioni i kërkuar për sa më sipër, është përcjellë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 8904/1 prot., datë 14.08.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 13027/1 prot., datë 08.08.2024, të Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve.
16. Për verifikim të mëtejshëm të kushteve të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si dhe në pikat 59 dhe 60 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, duke përcjellë formularin e vetëdeklarimit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të plotësuar nga kandidati jomagjistrat dhe ka kërkuar informacion për integritetin e kandidatit Ervin Aliu lidhur me ndonjë të dhënë

apo indicie e ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, kopje të dokumentacionit që përmban të dhëna në rastet e identifikimit të kandidatit jomagjistrat në kontakte me persona të pa përshtatshëm. Informacioni i kërkuar për sa më sipër Prokurorisë së Përgjithshme, është përcjellë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 923/1 prot., datë 23.06.2025.

17. Në funksion të verifikimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i lartë i Drejtësisë, i është drejtuar me kërkesë për informacion lidhur me çështje gjyqësore apo hetime penale në ngarkim të kandidatëve, gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhe prokurorive pranë tyre, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe Prokurorisë së Posaçme, të cilët kanë kthyer përgjigjet përkatëse.
18. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, që kanë të bëjnë me përvojën profesionale si "Jurist", jo më pak se pesëmbëdhjetë vite punë në çastin e kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën 2223, datë 03.08.2024 i është kërkuar Ministrisë së Brendshme përshkrimi i hollësishëm i llojit të punës, kontratë individuale nëse ka, rregullore, akte që kanë të përcaktuar detyrat ose përshkrim pune gjatë kësaj kohe të punësimit për periudhat e punësimit 01.03.2006-28.02.2008, 28.02.2008-13.09.2009, 08.11.2011-15.11.2013. Ministria Brendshme ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8894/1 prot., datë 22.08.2024, regjistruar në ILD me nr. 2223/3 prot., datë 23.08.2024, duke konfirmuar se kandidati ka mbajtur këto pozicione sipas periudhave 28.02.2008-13.09.2009 dhe 08.11.2011-15.11.2013, duke bashkëlidhur dhe kontratë pune nr. 829/2, datë 28.04.2008.

Sa i përket pozicionit si "Specialist i Lartë Policie" për periudhën 01.03.2006-28.02.2008 saktëson se nuk disponon të dhënat dhe për këtë i jemi drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Policisë, sipas shkresës nr. 1873, datë 13.06.2025 e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2145/1 prot., datë 23.06.2025, regjistruar në ILD me nr. 1873/1 prot., datë 24.06.2025 ka kthyer përgjigje duke përcjell kopje të urdhrave të ministrit të brendshëm, drejtorit të përgjithshëm të policisë, drejtorit dhe akte të drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorit.

Në vijim me kërkesën, sipas shkresës nr. 1994 datë 25.06.2025, drejtuar Ministrisë së Brendshme, ILD ka kërkuar përshkrimin e punës në pozicionin koordinator në njësinë e zhvillimit të prokurimeve për periudhën 28.02.2008 – 13.09.2009 dhe për periudhën 8.11.2011 – 15.11.2013, si dhe saktësimin nëse kandidati ka ushtuar detyrën e juristit apo jo. Ministria e Brendshme me shkresën nr. 3927/1 prot., datë 08.07.2025, regjistruar

në ILD me nr. 1994/1 prot., datë 09.07.2025, ka kthyer përgjigje duke shpjeguar se kandidati, z. Ervin Aliu ka qenë i punësuar pranë kësaj ministrie për periudhat e sipërcituara dhe se na ka vënë në dispozicion kontratat e punës si dhe aktet e emërimit të nëpunësit civil gjatë këtyre periudhave dhe nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen personale të ish punonjësit nuk disponohen të dhëna apo dokumentacion tjetër mbështetës.

Gjithashtu në kuadër të përvojës së punës së kandidatit, është kërkuar informacion, me shkresën nr. 2223/1 prot., datë 03.08.2024 Ministrisë së Mbrojtjes, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare Durrës, lidhur me përshkrimin e hollësishëm të llojit të punës, kontratë individuale nëse ka, rregullore, akte që kanë të përcaktuar detyrat, ose përshkrim pune, për periudhën e punësimit pranë këtij institucioni 22.04.2010-07.11.2011, kthyer përgjigje me shkresën nr. 494/1 prot., datë 07.08.2024, regjistruar në ILD me nr. 2223/2 prot., datë 09.08.2024, ku vërtetohet se kandidati ka qenë i punësuar pranë këtij institucioni si dhe ka përcjellë përshkrimin e punës.

Me shqyrtimin e të dhënave sa më sipër, është proceduar me kërkesë për shpjegime të kandidatit me e-mailin e datës 10.07.2025, me anë të të cilës kërkohen shpjegime mbi detyrat konkrete që keni ushtruar në pozicionin e “Koordinatorit në Njësinë e Zhvillimit të Prokurimeve” në Ministrinë e Brendshme, e lidhur kjo me faktin nëse është ushtruar detyra e juristit. Në përgjigje të këtij e-maili, është dërguar përgjigje e datës 24.07.2025 e protokolluar me nr. 2279/1 prot., datë 25.07.2025.

Në vijim, duke qenë se edhe nga të dhënat e sjellë në kthim përgjigjen e sipërcituar, nuk evidentohet se cilat ishin detyrat e kandidatit në pozicionin në Ministrinë e Brendshme, është proceduar me kërkesë sërish Ministrisë së Brendshme. Kjo e fundit me shkresën me nr. 3927/3 prot., datë 13.08.2025, regjistruar në ILD me nr. 2332/1 prot., datë 14.08.2025, informon se: *“Me ndryshimet në ligjin nr. 27/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, Drejtoria e Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme është suprimuar, e për rrjedhojë, të gjitha atributet i kanë kaluar për trajtim dhe kompetencë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, kështu që për zgjidhjen e kërkesës suaj drejtoheni pranë këtij institucioni.”*

Duke pasur në konsideratë përgjigjen e Ministrisë së Brendshme, i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila me shkresën me nr. 8967/1 prot., datë 12.09.2025, regjistruar në ILD me nr. 2440/1 prot., datë 15.09.2025 është informuar se: *“... nga verifikimi i fondeve arkivore të Arkivit të Punëve të Brendshme, rezulton se me krijimin e Operatorit të Blerjeve të Përqendruara në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është tërhequr edhe arkivi i kësaj strukture nga Ministria e Brendshme. Për këtë arsye duhet ti drejtoheni Operatorit të Blerjeve të Përqendruara lidhur me informacionin e kërkuar.”*

Sërish në konsideratat e kthim përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, i jemi drejtuar Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, i cili me shkresën me nr. 2877/1 prot., datë 23.09.2025 e regjistruar në ILD me nr. 2440/5 prot., datë 24.09.2025 ka informuar se: “... *periudhat e cituar nga ana juaj, konkretisht 28.02.2008 -13.09.2009 dhe 08.11.2011 -15.11.2013 përkojnë me kohën kur funksioni i prokurimit të përqendruar kryhej nga një drejtori brenda strukturës organike të Ministrisë së Brendshme. Ky funksion është transferuar në vitin 2018 në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara. Praktikisht, informacioni i kërkuar për z. Ervin Aliu duhej të disponohej nga stafi i burimeve njerëzore të Ministrisë së Brendshme dhe jo nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP). Sa më sipër, OBP SHA nuk disponon kopje të dokumentacionit të kërkuar nga ana juaj*”

Ndodhur përpara përgjigjeve të institucioneve sa më sipër, të cilat referonin tek njëra tjetra, i është dërguar sërish një shkresë të tre institucioneve njëherësh.

Në përgjigje, Operatori i Blerjeve të Përqendruara me shkresën nr. 2877/3 prot., datë 02.10.2025, regjistruar në ILD me nr. 2440/7 prot., datë 03.10.2025 informon se: “*Lidhur me informacionin mbi kriteret e punësimit të kandidatit në pozicionin “Koordinator në Njësinë e Zhvillimit të Prokurimeve” në Ministrinë e Brendshme dhe pas kontrollit në arkivën tonë, për periudhat 28.02.2008 -13.09.2009 dhe 08.11.2011-15.11.2013, ju bëjmë me dije se në arkivin e transferuar nuk disponojmë dokumente lidhur me rekrutimin/punësimin e z. Ervin Aliu, të kërkuar nga ana juaj.*”

Në përgjigje, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave me shkresën nr. 8967/3 prot., datë 02.10.2025, regjistruar në ILD me nr. 2440/8 prot., datë 03.10.2025 informon se: “... *lidhur me të dhënat arkivore në emër të z. Ervin Aliu, (urdhër, kontratë, kriterë punësimi), i cili ka ushtruar detyrën e “Koordinatorit në Njësinë e Zhvillimit të Prokurimeve” strukturë në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ju bëjmë me dije se në dokumentet e dorëzuar të Drejtorisë së Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk rezulton asnjë e dhënë në emrin e kërkuar.*”

Nga kontaktet me përfaqësues të kësaj ministrie rezulton se kjo strukturë nuk ka qenë në ambientet e këtij institucioni dhe dokumentet janë administruar pranë ambienteve ku ka ushtruar funksionet. Me shkëputjen e kësaj strukture nga Ministria e Brendshme si rrjedhojë e krijimit të një institucioni të ri me të njëjtat funksione, dokumentacioni arkivor i hartuar më herët duhej të dorëzohej apo të tërhiqej nga ky i fundit, ashtu si përcaktohet edhe në nenin 24, të “Normave tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Në përgjigje, Ministria e Brendshme me shkresën nr. 3927/5 prot., datë 07.10.2025, regjistruar në ILD me nr. 2440/10 prot., datë 08.10.2025 informon se: “*Njësia e Burimeve Njerëzore administron dosjen personale të z. Ervin Aliu, në të cilën, sikurse*

jeni informuar më parë, nuk gjendet dokumentacion provues që përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e ushtruara prej tij, si dhe kriteret e punësimit në pozicionin në fjalë.

Lidhur me dokumentacionin që mund të jetë pjesë e fondit arkivor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për periudhën e kërkuar, nëse ekziston dokumentacion i arkivuar mbi procedurën e ndjekur për shpalljen dhe kriteret e përcaktuara për pozicionin që ka mbajtur z. Aliu, mbajmë të njëjtin qëndrim të shprehur në shkresën tonë nr. 3927/3, datë 13.08.2025, sipas të cilit, fondi arkivor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në zbatim të ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 27/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", është tashmë në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave".

Për sa më sipër, si dhe në vijim të komunikimeve të mëparshme, ju informojmë se institucioni ynë nuk disponon dokumentacion shtesë përtej atij që ju është në dispozicion më parë."

Për sa më sipër, ndodhur në të njëjtat kushte ku nuk evidentohet se cilat kanë qenë detyrat e kandidatit në pozicionin Koordinator në Njësinë e Zhvillimit të Prokurimeve" në Ministrinë e Brendshme në periudhën 28.02.2008-13.09.2009 dhe 08.11.2011-15.11.2013, bazuar në vendimin nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", pika 19 e tij, i jemi drejtuar sërish kandidatit me e-mailin e datës 09.10.2025, me vënien në dijeni të këtyre gjetjeve, si dhe me të drejtën për të paraqitur brenda afateve të parashikuara, qëndrimin tuaj me shpjegimet përkatëse si dhe për tërheqjen e dokumenteve përkatëse nëse vlerësohet.

Lidhur me kërkesën në fjalë, kandidati ka kthyer përgjigje me datë 07.11.2025, regjistruar me nr. 3125 prot., datë 07.11.2025 dhe nr. 3125/1 prot., datë 10.11.2025, duke dhënë shpjegime dhe dokumentacion shtesë. Në shpjegimet e tij, kandidati shprehet se: "Lidhur me detyrat e mia në pozicionin Koordinator në Njësinë e Zhvillimit të Prokurimeve" në Ministrinë e Brendshme në periudhën 28.02.2008-13.09.2009 dhe 08.11.2011 - 15.11.2013, në kushtet kur, siç është konstatuar dhe nga ana Juaj, nga institucionet shtetërore nuk është ruajtur asnjë dokumentacion, po i referohem vendimit të Këshillit të Ministrave nr.53, datë 21.1.2009 "Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe udhëzimit nr 1, datë 06.02.2009 "Për procedurat e prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë nga organi qendror blerës, Ministria e Brendshme".

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.53, datë 21.1.2009 "Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime", ka parashikuar detyrat e organit qendror blerës pranë Ministrisë së Brendshme, që në atë kohë ka qenë Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara. Konkretisht në këtë VKM, në pikën 4, janë parashikuar këto detyra:

"4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të mallrave e të shërbimeve, sipas artikujve të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi;*
- b) të bashkërendojë punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike, që do të zhvillojë si organ qendror blerës;*
- c) të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi;*
- ç) të shqyrtojë dhe miratojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse gjykohet se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimet publike ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, organi qendror blerës kryen rishikimin e specifikimeve teknike, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse, ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;*
- d) të unifikojë specifikimet teknike, për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse, ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra.*
- dh) të bashkërendojë punën për testimin e tregut, për përlllogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit. Në këto raste organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;*
- e) të shqyrtojë ankesat e operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit;*
- ë) të bashkëpunojë me Agjencinë e Prokurimit Publik, për mbarëvajtjen e procedurave të prokurimit".*

Detyrat e Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme janë të parashikuara dhe në udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1, datë 06.02.2009, "Për procedurat e prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë nga organi qendror blerës, Ministria e Brendshme". Konkretisht në këtë udhëzim, në pikat 2-8, janë parashikuar këto detyra:

"2. Autoritetet kontraktore dërgojnë pranë Organit Qendror Blerës Ministria e Brendshme, me anë të një kërkesë të veçantë të bërë në formë shkresore dhe elektronike, nevojat për mallrat dhe shërbimet e sipërpërmendura ku përcaktohen

specifikimet teknike, sasitë e mallrave ose shërbimeve, që do të prokurohen si dhe fondet në dispozicion (Pa TVSH).

3. Organi Qendror Blerës, Ministria e Brendshme, bashkëpunon me autoritetet kontraktore për të mbledhur të dhënat për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen, duke koordinuar punën për testimin e tregut me qëllim përlllogaritjen e të dhënave sasiore për mallrat që do të prokurohen para publikimit të tenderit. Organi Qendror Blerës verifikon përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin, dhe standardet teknike në fuqi.

4. Organi Qendror Blerës, Ministria e Brendshme shqyrton dhe miraton specifikimet teknike të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse gjykohet se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në pajtim me legjislacionin për prokurimin publik, ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e specifikimeve teknike në bashkëpunim dhe me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm vendas ose të huaj dhe në çdo rast duhet të informojë autoritetet kontraktore mbi ndryshimet e bëra.

5. Organi Qendror Blerës, Ministria e Brendshme është plotësisht përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit (duke filluar nga njoftimi i kontratës deri në njoftimin e fituesit. Secili autoritet kontraktor brenda 5 ditëve pas nënshkrimit të kontratës së lidhur është i detyruar të dërgojë pranë Organit Qendror Blerës njoftimin e gjatë dhe të shkurtër të kontratës së lidhur në formë të shkruar dhe elektronike (CD), i cili do të do të hidhet në sistem nga Organi Qendror Blerës.

6. Organi Qendror Blerës, në raste përjashtimore, zhvillon procedura prokurimi për objektet e përcaktuara, ose jo, në VKM- e nr.53, datë 21.01.09 "Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime", edhe për ato autoritete kontraktore të cilët nuk janë përcaktuar në këtë VKM.

7. Kur autoritetet kontraktore, kanë kërkesa pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit Organi Qendror Blerës verifikon arsyet e vonesës dhe në varësi të tyre, vendos për shpalljen ose jo të procedurës së re të prokurimit për këto kërkesa.

8. Organi Qendror Blerës, Ministria e Brendshme, pas mbledhjes së të dhënave nga autoritetet kontraktore, nis procedurat e prokurimit, sipas ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik" me ndryshime, dhe Dokumentet Standarde të Tenderit. Kur vlera për mallrat dhe shërbimet e përcaktuara në VKM, nr. 53, datë 21.01.2009, gjatë një viti buxhetor është deri në 400.000 mijë lekë (pa TVSH), prokurimi do të kryhet nga vetë autoritetet kontraktore sipas procedurës së prokurimit me vlera të vogla".

Duke qenë se Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme është ngarkuar për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, një pjesë të detyrave të saj

mund ti gjejmë dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i cili në kreun i pika 2 ndër të tjera parashikon:

"...

ç) Në bazë të një marrëveshjeje të shkruar ose të udhëzimeve administrative, organi qendror blerës kryen procedurën e prokurimit në emër të çdo autoriteti kontraktor, ndërsa ky i fundit përcakton specifikimet teknike, sasitë e mallrave, të punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, dhe fondet në dispozicion.

d) Organi qendror blerës shqyrton dhe miraton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

Nëse organi qendror blerës gjykon se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimin publik ose se mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre. Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me specialistë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me specialistë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet.

Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore, kanë marrë për bazë çmime të ndryshme, për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përllogarit të dhënat sasiore, sipas fondit të vënë në dispozicion.

dh) Organi qendror blerës mund të kërkojë, në çdo fazë të prokurimit, ndihmën e autoritetit kontraktor, si dhe duhet t'i sigurojë këtij të fundit, sa herë që i kërkohet, akses të plotë për çdo informacion për procedurën e prokurimit.

e) Organi qendror blerës është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit (që nga njoftimi i kontratës e deri te botimi i njoftimit të shpalljes së fituesit), ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga autoriteti kontraktor".

Të gjitha detyrat e sipërcituara, janë ushtruar nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme, nëpërmjet koordinatorëve, një prej të cilëve kam qenë dhe unë. Pra unë kam ushtruar të gjitha detyrat e cituara më sipër nga këto VKM dhe udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Të gjitha këto përshkrime pune si më lart, janë përshkruar në mënyrë të përmbledhur dhe në shpalljen e Departamentit të Administratës Publike, kopjen e të cilit ja u kam vënë në dispozicion në datën 24.7.2025. Konkretisht kjo shpallje bën këtë përshkrim:

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Koordinon dhe përgjigjet për kryerjen e procedurave të prokurimit, si organ qendror blerës, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrive të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të përcaktuara në VKM-në nr. 53, datë 21.01.2009.

- Unifikon kërkesat dhe specifikimet teknike të Autoriteteve Kontraktore, përllogarit fondin limit total si dhe bën testimin e tregut për unifikimin e çmimeve.

- Jep asistencë ligjore për prokurimet e përqendruara.

- Analizon dhe përgjigjet për ankesat e operatorëve të ndryshëm.

- Përfaqëson ministrinë në gjykata dhe prokurori për sqarimet që kërkohen në mënyrë specifike për procedurat e ankimuar.

- Hedh online, në sistemin e APP-së procedurat e prokurimit publik duke siguruar transparencë dhe konkurrencë të hapur.

Po ashtu, në rubrikën "Kriteret e veçanta" thuhet se:

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

a) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në drejtësi.

b) Të ketë njohuri të gjuhës angleze.

Vërtetësia e kësaj shpallje provohet dhe nga vendimi nr. 1780, datë 27.04.2017 i Gjykatës Administrative të Apelit. Shkaku i investimit të gjykatës nga ana ime me padi ka qenë pikërisht shpallja e vendit vakant të Koordinator, në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara, në Ministrinë e Punëve të Brendshme – Kategoria e pagës III-a, shpallje e cila është bërë gjatë kohës që unë isha nxjerrë në listë pritje nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme. Gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, në asnjë rast gjatë debatit gjyqësor nuk është kundërshtuar vërtetësia e provës së paraqitur nga ana ime (shpallja e vendit vakant nga ana e Departamentit të Administratës Publike), dhe as vërtetësia e faktit se vendi i shpallur ishte pikërisht vendi që mbuloja unë pranë Drejtorisë së Prokurimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara. Po nga ky vendim, në faqen 6 të tij, rezulton se unë i jam drejtuar me kërkesë Departamentit të Administratës Publike, me qëllim që të më pajiste me një kopje të shpalljes në formën e kërkuar nga ligji. Kjo e fundit, me shkresën Nr.358314 Prot. datë 05.01.2015 lënda "Kthim përgjigje" ka refuzuar ta bëjë një gjë të tillë. Të njëjtën kërkesë ja paraqita Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me qëllim detyrimin e Departamentit të Administratës Publike ta paraqiste kopjen e shpalljes, por dhe nga gjykata nuk u pranua një kërkesë e tillë. Në këto kushte e vetmja kopje e shpalljes që kam mundur të siguroj, dhe që përmban dhe detyrat e mija si koordinator, është ajo që ju kam vënë në dispozicion dhe që është shkarkuar nga faqja zyrtare në internet e Departamentit të Administratës Publike.

Në vijim, nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, mu vu në dispozicion shkresa nr. 890/7 prot, datë 17.03.2021, "Mbi trajtimin e gjyqësuesve nga Komisioni i Posaçëm". Në faqen e fundit të kësaj shkrese, në numrin 14 ku trajtohet praktika ime është shkruar: "Ervin Aliu. Pozicioni: Koordinator në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara, kat. III-a. Arsimi: Drejtësi".

Në kushtet kur nga kërkimet pranë institucioneve përkatëse nuk kanë rezultuar dokumente të tjera, mendoj se shkresa nr. 890/7 prot, datë 17.03.2021 e Ministrisë së

Brendshme, provon në mënyrë shteruese se unë jam rekrutuar në shërbimin civil me arsimin "Drejtësi" dhe kam ushtruar detyrat e mija si jurist pranë këtij institucioni.

Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", (i cili ka qenë ligji i kohës kur unë jam pranuar në shërbimin civil) në nenin 13 parashikon rregullat për pranimin në shërbimin civil. Në pikat 2 dhe 3 të këtij neni parashikohet se: "2. Në administratën qendrore shpallja e konkurrimit bëhet nga Departamenti i Administratës Publike, me kërkesën e institucionit përkatës. Në institucionet e pavarura shpallja bëhet nga departamentet e personelit. 3. Shpallja botohet në dy gazetatat me qarkullim më të madh të paktën 30 ditë para datës së caktuar për konkurrimin". Duke mbajtur parasysh këtij parashikimi ligjor ju drejtova Bibliotekës Publike të Bashkisë Durrës, ku në gazetën "55" të datës 4.5.2012, në faqen 11 të kësaj gazete, gjeta shpalljen e konkurrimit nga Departamenti i Administratës Publike, për vendin e lirë në pozicionin Koordinator, në Drejtorinë e Prokurimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, i cili ka qenë pozicioni im i punës. Nga kjo shpallje rezulton se një nga kërkesat e veçanta për kandidatin është: **"Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Fakultetin e Drejtësisë"**. Paga e pozicionit është në kategorinë III-a. Këto përputhen plotësisht me shpalljen e Departamentit të Administratës Publike të nëntorit 2014 të cilën e kam paraqitur para Jush. Në vijim të shpalljes të datës 04.05.2012, parashikohet se: **"Konkurrimi do të bazohet në njohuritë mbi rekomandimet e qeverisë në lidhje me zbatimin e ligjit, shtetin ligjor, luftën kundër korrupsionit, qeverisje me duart e pastra (programi i qeverisë www.keshilliministrave.al), Kodin e Procedurave Administrative, Legjislacionin e Shërbimit Civil, Ligjin 9131 dt. 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", ligjin nr. 9367 dt. 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", ligji 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar"**.

Sa më sipër, rezulton se shpallja në gazetën "55" të datës 4.5.2012 është për pozicion pune jurist dhe konkurrimi është bërë për të testuar njohuritë në fushën e drejtësisë dhe njohjes së ligjeve, pavarësisht se formalisht pozicioni i punës ka emërtimin "Koordinator". Arsyen e këtij emërtimi e kam shpjeguar në sqarimet e mëparshme të datës 24.07.2025.

Gjithashtu ju bëj me dije se në datën 10 qershor 2015 kam filluar të ushtroj detyrën Ndihmës Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo është bërë e mundur nëpërmjet kalimit të një procesi seleksionues dhe procedure konkurrimi sipas parashikimeve të ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Në nenin 6/3 të këtij ligji parashikohet se kandidati për ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të

Apelit duhet të ketë mbi 7 vjet përvojë profesionale si jurist në organet e sistemit të drejtësisë, në funksione publike në administratën e Kuvendit, administratën e institucionit të Presidentit, aparatit të Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, në Prokurori, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës. Bazuar në nenin 6/4 të këtij ligji, komisioni ad hoc, pasi shqyrton të gjitha kërkesat, verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore, të parashikuara nga neni 6/3, i këtij ligji, për të vijuar procesin e testimit dhe shpall listën e konkurrentëve për pjesëmarrjen në konkurrim, organizon dhe zhvillon testimin seleksionues dhe në përfundim të tij publikon rezultatet. Referuar nenit 6/5 të këtij ligji, Komisioni ad hoc ka pasur në përbërje: a) kryetarin e gjykatës ku janë shpallur vendet vakante; b) një gjyqtar të asaj gjykate; c) kancelarin e asaj gjykate; ç) një përfaqësues të strukturës përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë; d) një pedagog të së drejtës administrative në institucionet e arsimit të lartë me gradë shkencore jo më të ulët se "Doktor"; dh) dy pedagogë të Shkollës së Magjistraturës.

Komisioni ad hoc sipërcituar, mbasi ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga unë, diplomën universitare, CV dhe librezën e punës, ka arritur në konkluzionin se unë e kam plotësuar kriterin e kërkuar të vjetërsisë në punë, pasi kam punuar jurist pranë Ministrisë së Brendshme, dhe si i tillë, u kualifikova për vazhdimin e mëtejshëm të fazave të konkurimit, ku dhe u kualifikova dhe u shpalla fitues.

Sa më lart, vlerësoj se plotësoj kriteret ligjore për kandidimin për pozicionin "Inspektor jomagjistrat" pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo bazuar dhe në shpalljen e bërë nga ana Juaj për vendet vakante në këtë pozicion pune, ku në pikën 1.1 "Kushtet dhe kriteret" në pikën c) kërkohet të plotësohet kushti: "c) Në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet". Nga sa ju parashtrova më lart dhe kam provuar me aktet shkresore që ju kam vënë në dispozicion, jam diplomuar jurist pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe jam punësuar pranë Ministrisë së Brendshme me këtë diplomë. Në këtë shpallje nuk kërkohet që kandidati të ketë kryer detyra të caktuara, por mjafton fakti që të ketë përvojë pune si jurist për të paktën 15 vjet, kriter të cilin mendoj se e plotësoj.

Nga gjithë sa sqarova më sipër, Ju parashtroj se detyrat konkrete që unë kam **ushtruar në pozicionin e "Koordinatorit në Njësinë e Zhvillimit të Prokurorive" në Ministrinë e Brendshme**, janë ato të cituara në shpalljen e Departamentit të Administratës Publike sipërcituar, të cilat mund të kryhen vetëm nga një jurist dhe unë jam punësuar si i tillë, pasi si i tillë jam diplomuar nga Fakulteti i Drejtësisë dhe në bazë të kësaj Diplome kam përmbushur kriteret e veçanta të punësimit në këtë pozicion pune.

Nga sa sipër, çmoj se kam provuar në mënyrë shteruese dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se në periudhën 28.02.2008-13.09.2009 dhe 08.11.2011-15.11.2013, kam **ushtruar detyrën e juristit pranë Ministrisë së Brendshme**.

Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve ju vë në dispozicion:

- Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 1, datë 06.02.2009, "Për procedurat e prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë nga organi qendror blerës, Ministria e Brendshme".

- Shkresa e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 890/7 prot, datë 17.03.2021, "Mbi trajtimin e gjyqëfituesve nga Komisioni i Posaçëm".

- Vendimi nr. 1780, datë 27.04.2017 i Gjykatës Administrative të Apelit.

- Fragment nga gazeta "55" e datës 4.5.2012."

18.1. Në kuadër të verifikimeve për kriterin e përvojës profesionale si "jurist" është proceduar me kërkesë për informacion Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Arkivit Qendror me shkresën nr. 2232 prot, datë 03.08.2024, në lidhje me periudhën e derdhjes të kontributeve të sigurimeve shoqërore, **si dhe Drejtorisë Rajonale Durrës me shkresën nr. 2834 prot., datë 22.10.2024.** Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8503/1 prot, datë 09.08.2024, Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën nr. 8294/1 prot, datë 20.08.2024 dhe me shkresën nr. 18449/1 prot, datë 23.08.2024, **ndërsa Drejtoria Rajonale Durrës me shkresën nr. 18473/1 prot., datë 29.10.2024.**

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të parashikuar në nenin 209, pika 6, germa "ç", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", u vlerësua t'i drejtohem me kërkesë për informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë me nr. 2238 prot., datë 03.08.2024 duke kërkuar nëse kandidati, në mënyrë aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit. Dhoma Kombëtare e Avokatisë është përgjigjur me shkresën nr. 350 prot., datë 04.09.2024.

20. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe pikës 62, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit nëse kandidati, përfshihet në rastin e posaçëm të nenit 209, pika 6, germa "e", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar: "e) *ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2*

korrikut 1991" apo në njërin nga rastet e pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë." Me shkresën nr. 2231 prot, datë 03.08.2024, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

21. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1312/3 prot, datë 20.08.2024 ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, informacionin, i cili është bashkëngjitur praktikës së kandidatit (*Vendim nr.501, datë 20.08.2024* i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit).
22. Në vijim të procedurave të verifikimit që lidhen me integritetin e kandidatëve për inspektorë jomagjistratë si dhe për të shmangur çdo lloj konflikti interesi që bie ndesh me nenin 209, pika 6, germat "dh", "ë" dhe "f" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, është njoftuar zyrtarisht kandidati që të plotësojë formularët përkatës që lidhen me:
- mospasjen e funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
 - mosqenien bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
 - mosqenien anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

Për sa i takon kandidatit Ervin Aliu, është paraqitur në ambientet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ka dorëzuar të plotësuar secilin prej formularëve të mësipërm.

23. Gjithashtu në funksion të verifikimit sipas germave "dh" dhe "f", është proceduar edhe me kërkim informacion nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e cila ka kthyer përgjigjet përkatëse sipas shkresës me nr. 3572/1 prot., datë 13.06.2025.
24. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 27 e vijues, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Kryetari i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka

thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 10.11.2025, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit të kandidimit të z. Ervin Aliu, për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komitetit

25. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatit Ervin Aliu për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
26. Në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, konkretisht në nenin 209, në pikën 6, përcaktohen "Kushtet për inspektor jomagjistrat", prej nga rezultojnë se:

Kandidatët për inspektorë, të cilët nuk janë magjistratë, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;
 - b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;
 - c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet;
 - ç) në kohën e kandidimit, të mos kenë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit të paktën 2 vitet e fundit;
 - d) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
 - e) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991;
 - ë) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;
 - f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.
27. Përsa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar nga ana ILDKPKI-së, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", me

aktin nr. 207/23 prot, datë 19.12.2024, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Ervin Aliu dhe personat e lidhur me të.

28. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Ervin Aliu ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

29. Pra, mbi bazën e verifikimeve të kryera nga organi përgjegjës, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve arrin në përfundimin se hetimi i thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI janë të plota dhe shteruese sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, lidhur me kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Ervin Aliu.

30. Për këto arsye, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"*, të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *"Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit"*, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, *"Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"*, Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Ervin Aliu ka *"kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij"*. Për rrjedhojë, për sa më sipër, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

31. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "a" e ligjit nr. 115/2016, *"a) të jetë shtetas shqiptar me diplomë të nivelit të dytë në drejtësi dhe me rezultate të larta në studimet universitare;"* nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Ervin Aliu ka depozituar diplomën nr. 6452, datë 06.07.2000 të arsimit të lartë lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ku vërtetohet se ka marrë titullin "Jurist". Kjo diplomë, referuar nenit 124/2 të ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, ku

parashikohet se diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), sipas parimeve të procesit të Bolonjës, është ekuivalente me diplomat “Master i shkencave”. Për rrjedhojë kandidati Ervin Aliu nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit.

32. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga nenit 209, pika 6, germa "b" e ligjit nr. 115/2016, *“b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale”*, nga aktet e administruara në dokumentacionin e aplikimit, kandidati Ervin Aliu e plotëson këtë kriter.
33. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "b" e “d” të ligjit nr. 115/2016, *b) të kenë integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale”* dhe *“të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi”*, nga aktet e administruar nga Organet ligjzbatuese, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme, zyrat e prokurorëve dhe gjykatave ka rezultuar se nuk ka të dhëna që të ketë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi, apo të dhëna të tjera në funksion të parashikimeve në nenin 2 të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, si dhe të dhëna të vlerësuar për verifikimin e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, referuar parashikimit të pikës 79 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *“Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit”*.

Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretime të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

34. Për rrjedhojë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese dhe institucione të tjera kushtetuese të lartpërmendura, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa “b” dhe “d” të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

35. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016, pra që kandidati *"c) në kohën e kandidimit, të kenë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet"*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë diplomën/kualifikimet, jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetimit të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Ervin Aliu ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- Sekretar gjyqësor Gjykata e Rrethit Durrës për periudhën 01.12.1994 – 01.12.1996.
- Jurist KESH, për periudhën 01.03.2001 – 01.11.2002
- Specialist i lartë policie Ministria e Brendshme për periudhën 01.03.2006 – 28.02.2008
- Koordinator Njësia e Zhvillimit të Prokurimeve, Ministria e Brendshme për periudhën 28.02.2008- 13.09.2009.
- QNOD Durrës, specialist i zyrës së Trajnimeve për periudhën 22.04.2010 – 07.11.2011.
- Koordinator Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve, Ministria e Brendshme për periudhën 08.11.2011- 15.11.2013.
- Ndihmës ligjor Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, për periudhën 10.06.2015 – 20.02.2023.
- Ndihmës ligjor Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për periudhën 21.02.2023 – aktualisht.

Lidhur me periudhat sa më sipër, janë kërkuar dhe marrë informacionet e sipërshkruara, ku referuar shpjegimeve të kandidatit ndër të tjera lidhur me pozicionin e koordinatorit pranë Ministrisë së Brendshme për të dy periudhat 28.02.2008- 13.09.2009 dhe 08.11.2011- 15.11.2013, lidhur me funksionin jurist, nga dokumentacioni i sjellë prej tij është evidentuar një njoftim për vend të lirë pune për pozicionin e koordinatorit në Drejtorinë e Prokurimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme dhe atë të Drejtorit në Drejtorinë Teknike në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme. Këto njoftime rezultojnë që kanë parashikuar si afat për paraqitjen e dokumenteve, datën 04.06.2012 dhe në kërkesat e veçanta është parashikuar mbarimi i arsimit të lartë në Fakultetin e Drejtësisë. Data në fjalë rezulton të jetë e përfshirë në periudhën 08.11.2011- 15.11.2013, kur kandidatit ka qenë Koordinator Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve, Ministria e Brendshme.

36. Bazuar në gjetjet e cituara më sipër, Komiteti konstaton se kandidati Ervin Aliu ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga neni 209, pika 6, germa "c" e ligjit nr. 115/2016. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

37. Për sa i përket urdhërimeve të nenit 209, pika 6, germa "ç", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të Vendimit Nr. 536, date 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *"Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë së kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit"*, ku kërkohet që kandidati për inspektor jomagjistrat, të mos ketë ushtruar në mënyre aktive, profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit është kthyer përgjigje nga Dhoma Kombëtare të Avokatisë me shkresën nr. 350 prot., datë 04.09.2024. Në bazë të kësaj përgjigje rezulton se z. Ervin Aliu, ka licencë me nr. 1929, në vitin 2003 dhe me status pasiv 2003-2024. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
38. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, gjerat "dh", "e", "ë" dhe "f", të ligjit nr. 115/2016, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Ervin Aliu, në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si dhe atë të mbërritur nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
39. Në nenin 209, pika 6, gjerat "dh" dhe "f" të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët "dh) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit" dhe f) të mos jenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit". Për verifikimin e këtyre kushteve për kandidatin në fjalë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar informacion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr. 1566, datë 21.05.2025 lidhur me verifikimin në regjistrat elektronik që mban gjykata për të dhënat që kanë të bëjnë me mbajtjen e pozicioneve drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit, duke filluar nga data 27.05.2024, si dhe me anëtarësinë në organet drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit duke filluar nga data 27.05.2024..
40. Bazuar në kthimin e përgjigjes së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr. 3572/1 prot., datë 13.06.2025, si dhe referuar formularit të vetëdeklarimit, kandidati Ervin Aliu nuk rezulton të ketë mbajtur funksione politike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit apo të jetë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata në kohën e kandidimit. Për rrjedhojë kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit sipas gjerave "dh" dhe "f" të pikës 6 të nenit 209 të ligjit me nr. 115/2016.

41. Në nenin 209, pika 6, germa “e” të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët *“të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991”*. Për verifikimin e këtij kriteri për kandidatin në fjalë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit tek Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, formularin e aplikimit *“Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”* të parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të plotësuar nga kandidati.

42. Në përgjigje të kërkesës tonë, është administruar vendimi nr.501, datë 20.08.2024 Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, nga ku rezulton se, kandidati Ervin Aliu:

- *Nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm;*
- *Nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit;*
- *Nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tij sipas pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i ndryshuar.*

Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa “e” të ligjit nr. 115/2016, kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit.

43. Në nenin 209, pika 6, germa “ë” të ligjit nr. 115/2016, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatët *“të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret;”*, e për këtë qëllim është dorëzuar dhe nënshkruar nga kandidati deklarata me anë të së cilës kandidati deklaron se nuk është bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi sekret më datë 09.07.2024. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshi këtu dhe formularin e vetëdeklarimit në dosjen e kandidimit, Komiteti konstaton se kandidati Ervin Aliu, nuk rezulton të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i ndonjë shërbimi sekret, në kohën e kandidimit. Për rrjedhojë, kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

44. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet me sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për Inspektor jomagjistrat, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit Ervin Aliu, në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024, pasi kandidati plotëson të gjitha kriteret parashikuara në nenin 209, pika 6, të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave *“Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për*

verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, pikës 27 e vijues të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:


V E N D O S I:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit z. Ervin Aliu, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Ervin Aliu.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR

Lindita Ziguri



KRYETAR

Elena Pelushi



ANËTAR

Joana Sorraj

